

# Faktet reale për mitet e zakonshme rreth vaksinës kundër COVID-19.

NYC  
HEALTH+  
HOSPITALS

Rreth vaksinës kundër COVID-19 qarkullojnë shumë informacione. Shumë prej tyre nuk janë të vërteta. Mësoni faktet dhe qëndroni të shëndetshëm.

**Miti: Vaksinat kundër COVID-19 nuk janë të sigurta, sepse janë bërë shumë shpejt.**

**Fakti: Vakina është vërtetuar shkencërisht që është e sigurt dhe efektive.**

Vakina kundër COVID-19 i ka kaluar provat klinike dhe shqyrtimet e sigurisë për të marrë autorizim nga Agjencia e Ushqimeve dhe e Barnave (Food and Drug Administration, FDA). Mbi 40 000 njerëz kanë marrë pjesë në provat klinike të vaksinës së Pfizer dhe mbi 30 000 në provat nga Moderna.

**Miti: Vakina kundër COVID-19 shkakton efekte anësore dhe reaksione alergjike vërtet të rënda.**

**Fakti: Vakina mund të shkaktojë efekte të lehta anësore, ashtu si vaksinat e tjera.**

Efektet më të zakonshme anësore janë lodhja, dhimbja e kokës, dhimbja ose skuqja rreth zonës së injektimit dhe dhimbja e muskujve ose e kyçeve. Efektet anësore si këto, megjithëse janë të pakëndshme, të gjitha janë shenja se trupi juaj po punon për të mbrojtur veten nga virusi që shkakton COVID-19. Njerëzit që kanë pasur reaksime të rënda alergjike ndaj përbërësve të kësaj vaccine nuk duhet ta marrin vaksinën.

**Miti: Unë nuk jam në rrezik që të sëmurem rëndë me COVID-19, kështu që s'kam nevojë për vaksinën.**


**Fakti: Pavarësisht nivelit të rrezikut, ju gjithsesi mund ta merrni virusin dhe ta përhapni.**

Pasi të ketë qarkulluar gjerësisht, administrimi i vaksinës te sa më shumë të rritur të jetë e mundur do të ndihmojë në mbrojtjen e komuniteteve tona nga virusi - kjo quhet ndryshe imunitet i tufës.

**Miti: Mund të zë COVID-19 nga vakina.**

**Fakti: Nuk mund të zini COVID-19 nga vakina.**

Asnjë nga vaksinat e aprovuara kundër COVID-19 nuk përdor virus aktiv. Nuk ka asgjë në vaksinë që të mund të shkaktojë COVID-19. Vaksinat e Pfizer dhe të Moderna përdorin mRNA, që është acidi ribonukleik mesazher. mRNA i mëson qelizat tona si të prodhojnë një proteinë që shkakton përgjigje imune në trupat tanë. Kjo përgjigje imune që prodhon antitrupa na mbron nga infektimi nëse virusi i vërtetë hyn në trupat tanë.



**Kush është pro një vaccine kundër COVID-19, të ngrejë dorën.**

**Miti:** Vaksina kundër COVID-19 mund të më ndryshojë ADN-në ose përbërjen gjenetike.

**Fakti:** Vaksina nuk mund ta ndryshojë ADN-në apo përbërjen gjenetike të një personi.

mARN në vaksinë nuk ndikon as bashkëvepron kurrë me materialin tuaj gjenetik në asnjë formë. Trupi e largon mARN pas 1-2 javësh.

**Miti:** Përdorimi i mARN në vaksina është një teknologji e re për të cilën ne dimë pak.

**Fakti:** Shkencëtarët e kanë studiuar përdorimin e mARN në vaksina për dekada.

**Miti:** Unë e kam kaluar COVID-19, kështu që nuk kam nevojë për vaksinën.

**Fakti:** Vaksinën duhet ta bëni edhe nëse e keni kaluar COVID-19.

Ekspertët nuk e dinë nëse antitruapat nga infeksioni mund të mbrojnë nga riinfektimi. Ju mund ta bëni vaksinën sapo t'ju largohen simptomat dhe pasi të përfundojë periudha e rekomanduar e izolimit.

**Miti:** Vaksina implanton mikroçipe gjurmuese te njerëzit.

**Fakti:** Nuk ka pajisje gjurmimi në vaksinë.

Nuk ka mikroçipe apo pajisje gjurmimi në vaksinë. Ky mit ka dalë në internet me pretendime të rreme rreth mikroçipeve në vaksina.

**Miti:** Nëse jam alergjik ndaj vezëve, nuk mund ta bëj vaksinën kundër COVID-19.

**Fakti:** Vaksina kundër COVID-19 nuk përmban vezë.

**Miti:** Vaksina kundër COVID-19 bëhet me inde fetusi.

**Fakti:** Vaksina nuk përmban inde fetusi.

Përbërësit në vaksinë përfshijnë mARN, ujë të kripur, amine dhe sheqer.

**Miti:** Pasi të bëj vaksinën kundër COVID-19, nuk ka më nevojë të mbaj maskë.

**Fakti:** Maskën duhet të vazhdoni ta mbani dhe të ruani distancimin fizik pasi të keni bërë vaksinën.

Edhe nëse e bëni vaksinën duhet të vijoni të ndiqni udhëzimet e sigurisë kundër COVID-19. Vaksina ju mbron të mos sëmureni nga COVID-19, por ekspertët nuk e dinë nëse mund ta bartni virusin dhe t'ua përhapni të tjerëve.



Bisedoni me ofruesin tuaj të kujdesit shëndetësor nëse keni ndonjë pyetje. Mësoni më shumë rreth vaksinës kundër COVID-19 te [nychealthandhospitals.org/covidvaccine](https://nychealthandhospitals.org/covidvaccine).

